



SH. 04 prot
Dt. 05/02/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 2, datë 31.01.2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË AUTORIZIMIT,
NGA SHOQËRIA "W.T.S-ENERGJI" SH.P.K TEK SHOQËRIA "SELCA
ENERGJI" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e autorizimit Nr.3, datë 06.04.2010 "Autorizim i posaçëm për përdorim rezerve ujore për prodhim hidroenergjie, HEC VUKEL", nga shoqëria "W.T.S-Energji" sh.p.k me Nipt K48109743L tek shoqëria "Selca Energji" sh.p.k me Nipt K98510701M, me vendndodhje: Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

